

**UDHËZUES**

**MBI NJOHJEN ME TË DHËNAT BIOMETRIKE**  
**(SHTOJCË: TË DHËNAT BIOMETRIKE NË VENDIN**  
**E PUNËS)**

**Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Human  
Dynamics dhe në asnjë mënyrë nuk mund interpretohet si reflektim  
i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian**

## I. HYRJJE

Në botën moderne, biometrika po fiton rëndësi, nga ana tjetër shoqëria po përballet gjithashtu me shumë vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me qëndrimin afatgjatë kundrejt tyre. Gjithnjë e më tepër kemi një rritje të përdorimit të biometrikës. Ajo mund të vihet re në një sërë fushash dhe është përdorur për qëllime të ndryshme, si: mbrojtja, masa kufitare shtetërore, emigrimi, pasaportat, bankat dhe institucionet financiare, sistemet e informacionit, etj.

Nga këndvështrimi i individit, biometrika ka disa avantazhe praktike. Ashtu si çdo teknologji tjetër, ajo mund të përdoret në një mënyrë miqësore me privatësinë e individit, por nga ana tjetër mund të nënkuptojë një ndërhyrje serioze në privatësinë e individit.

Përmasat biometrike nga natyra e tyre përfaqësojnë një ndërhyrje në privatësinë dhe dinjitetin e individit, prandaj të gjitha kushtet në të cilat ato duhet të përdoren duhet të interpretohen në dritën e mbrojtjes së privatësisë dhe dinjitetit.

### *Qëllimi i dokumentit*

Ky Udhëzues *shpjegon rregullat përkatëse* kur dhe në çfarë kushtesh kontrolluesit mund të paraqesin të dhëna personale biometrike, si dhe çfarë janë të detyruar të marrin parasysh.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është;

- ✚ të shpjegojë karakteristikat bazë të përmasave biometrike;
- ✚ të ilustrojë disa nga dilemat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e biometrikës, si dhe;
- ✚ të japë përgjigje pyetjeve që hasen shpesh nga subjekte të sektorit privat e publik që synojnë të paraqesin përmasa biometrike.

Gjithashtu paraqet një hyrje në biometrikën në vendin e punës.

### *Baza ligjore*

Me ndihmën e këtyre shpjegimeve, përgjigjeve dhe udhëzimeve, shoqëritë dhe kontrolluesit e tjerë të të dhënave dhe përpunuesit duhet përkatësisht të jenë në pajtim me dispozitat dhe parimet e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Nr. 9887, datë 10.04.2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012); më poshtë referuar “LMDHP”), standardet dhe parimet ndërkombëtare dhe rregullat e BE-së (Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 24.10.1995 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”).

### *Kujt i drejtohet ky udhëzues?*


Ky Udhëzues i drejtohet kontrolluesve të të dhënave, përpunuesve dhe kujtdo shoqërie tjetër që përpunon të dhëna personale biometrike.

## ***Çfarë do të thotë në të vërtetë “të dhëna biometrike”?***

Përkufizuar në mënyrë të thjeshtë, “biometrika” është shkenca e identifikimit të një personi në bazë të karakteristikave të tij fiziologjike ose të sjelljes, të cilat nuk i ka të përbashkëta me askënd tjetër dhe për këtë arsye ato janë unike dhe të qëndrueshme. Në fakt, ne të gjithë jemi të identifikueshëm me anë të karakteristikave të tilla si shenjat e gishtave, vijat papilare në një gisht, irisi, retina, fytyra, veshët, AND-ja, dhe madje edhe postura jonë tipike dhe ecja. Disa të dhëna fizike, fiziologjike dhe të sjelljes janë të përshtatshme për identifikimin e një individi, nëse ato mundësojnë një matje biometrike të saktë dhe të besueshme, që mund të funksionojë si një "fjalëkalim" unik dhe individual i një personi.

Karakteristikat e mëposhtme të njeriut janë më shpesh të përdorura në biometrikë:

**Karakteristika të sjelljes** si firma, të folurit (diksioni i zërit), mënyra e të lëvizurit, etj.



**Karakteristika fizike** si shenjat e gishtave, të duarve, karakteristikat e fytyrës, irisi, retina, veshi, struktura e venave në krah, aroma, AND-ja.

Si rregull përmasat biometrike janë unike për çdo individ, jo të transferueshme tek të tjerët, e pamundur të harrohen apo të humbasin, është e vështirë të riprodhohen apo falsifikohen, janë të përdorshme me ose pa dijeninë/ pëlqimin e individit, është e vështirë të ndryshohen ose fshihen.

## ***Çfarë nënkupton përpunimi i të dhënave personale (biometrike)?***


“**Përpunim i të dhënave personale**” (sipas pikës 12 të neni 3 të LMDHP) është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Të dhënat biometrike (si shenjat e gishtave, irisi, retina, tiparet e fytyrës, etj) ofrojnë burime të karakteristikave që janë unike dhe i atribuohen vetëm një individi, dhe duke qenë karakteristika me anë të së cilave identifikohet ose të paktën është i identifikueshëm një individ, ato padyshim përbëjnë të dhëna personale. Prandaj, çdo mbledhje, ruajtje, ndarje, dërgim ose shkatërrim i këtyre të dhënave do të konsiderohet si përpunim i të dhënave personale, dhe për pasojë do të rregullohet posaçërisht nga dispozitat e LMDHP-së.

Për të kuptuar më mirë përpunimin e të dhënave biometrike, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet verifikimit dhe identifikimit. Dallimi ndërmjet këtyre dy fushave të zbatimit është thelbësor për shkak se zbatimi i verifikimit dhe identifikimit përdoren për detyra të ndryshme në fusha që nuk krahasohen ndërmjet tyre.

### ***Çfarë është identifikimi biometrik?***


Një nënshkrim biometrik (model, mostër) i një personi të panjohur futet në sistem. Sistemi biometrik krahason këtë mostër me mostrat e personave të njohur, mostrat e të cilëve janë mbledhur në bazën e të dhënave. Pas procesit të krahasimit sistemi përgjigjet nëse mostra e individit të panjohur është gjetur në bazën e të dhënave. Kur rezultati është pozitiv, personi i panjohur është identifikuar. Ky model është i njohur si “një-me-shumë”.



### ***Çfarë është vërtetimi (verifikimi) biometrik?***

Në verifikimin biometrik, mostra e një individi krahasohet me një karakteristikë të dhënë. Për këtë operacion personi duhet së pari të japë një shembull të karakteristikës së veçantë për verifikim. Ky proces (i quajtur “regjistrim”) me metoda matematikore e konverton atë në një formë dixhitale, mostër (p.sh. imazhi i shenjave të gishtit) të karakteristikës që mund të ruhet në një skedar kompjuterik ose në një kartë memorie smart. Mostra përdoret kur është e nevojshme për ta krahasuar me një grup karakteristikat të dhëna për verifikim.

Sistemi i krahason dy mostra, njëra që vendoset në kohë reale (tipari real), e dyta është futur më parë në disk të cilën individi e shpall si pjesë të identitetit të tij. Kur procesi i krahasimit është identik (që ka shumë probabilitet) atëherë sistemi beson se identiteti i shpallur është i duhuri. Ky model njihet si modeli “një-me-një”.



***Për shembull ;***

Në modalitetin e verifikimit, teknologjitë biometrike kryejnë një krahasim të vetëm të të dhënave aktuale me një mostër të ruajtur më parë. Shembull i kësaj është skaneri i gjurmëve të gishtave në një kasafortë elektronike. Në modalitetin e identifikimit përdoret një bazë të dhënash biometrike. Një element individual i të dhënave kapet, dhe sistemi përpiqet ta krahasojë këtë pjesë të dhëne me ndonjë nga elementet ekzistues të përcaktuar në bazën e të dhënave. Një shembull i identifikimit biometrik është baza e të dhënave me shenjat e gishtave të kriminelëve të njohur.

Përpunimi i të dhënave biometrike përdoret shpesh tashmë në procedurat e vërtetimit automatik / verifikimit dhe identifikimit, në veçanti për kontrollin e hyrjes në zona fizike dhe virtuale (p.sh. aksesit në sisteme të veçanta elektronike ose shërbime).

Duke pasur parasysh evoluimin e shpejtë teknik dhe shqetësimin në rritje për sigurinë, shumë sisteme biometrike punojnë duke kombinuar modalitete të ndryshme biometrike të përdoruesit me teknologji të tjera identifikimi ose verifikimi. Disa sisteme për shembull grumbullojnë njohje të fytyrës dhe regjistrimin e zërit.

Mbledhja e mostrave biometrike, të ashtuquajturat të dhënave biometrike (p.sh. imazhi i shenjave të gishtave, foto të irisit ose të retinës, regjistrimi i zërit), kryhet gjatë një faze të quajtur “regjistrim”, duke përdorur një sensor të veçantë për çdo lloj të dhëne biometrike. Sistemi biometrik nxjerr ekstrakte nga të dhënat biometrike, karakteristika specifike të përdoruesit, për të ndërtuar “një mostër” biometrike. Mostra është një reduktim i strukturuar i një imazhi biometrik: përmasat biometrike të regjistruara të një individi. Është mostra, e paraqitur në formë të dixhitalizuar, e cila do të ruhet dhe jo vetë elementi biometrik. Për më tepër, të dhënat biometrike mund të përpunohen si të dhëna bazë të papërpunuara (një imazh) në varësi të funksionimit të sistemit biometrik që është në përdorim, duke vazhduar me një krahasim të të dy mostrave.

Kjo vlen edhe për sistemet e tjera biometrike, siç janë ato që bazohen në analizën e dinamikës së shtypjes së tastave në tastierë ose njohjen e fytyrës në distancë, për shkak të karakteristikave të veçanta të teknologjisë së përdorur. Aspekti problematik është se nga njëra anë kjo mbledhje dhe përpunim i të dhënave mund të bëhet pa dijeninë e subjektit të të dhënave dhe nga ana tjetër, pavarësisht besueshmërisë së tyre aktuale, këto teknologji biometrike bëhen objekt përdorimi të gjerë për shkak të “nivelit të ulët të bezdisjes” që ato kanë. Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen masa mbrojtje specifike në lidhje me to.<sup>1</sup>

Ka disa shqetësime në lidhje me fushën e teknologjive biometrike dhe ruajtjen në shkallë të gjerë të të dhënave biometrike. Për shembull, të dhënat mund të përdoren më vonë për qëllime me të cilat individi nuk ka rënë dakord, ose që informacioni ka shumë mundësi të vidhet. Një çështje tjetër që ngrihet shpeshherë, është se të depozitat me të dhëna biometrike mund të shpërdorohen për të diskriminuar disa grupe të popullsisë.

Për sa më sipër është tepër e rëndësishme të respektohen parimet për përpunimin e të dhënave biometrike që qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të jetë i ligjshëm e i drejtë sipas dispozitave të përcaktuara në LMDHP.

---

<sup>1</sup> Dokumenti i punës për biometrikën 12168/02/EN WP 80 – Grupi i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave- Neni 29

## II. PARIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN E DREJTË

Të dhënat personale biometrike sipas dispozitave të LMDHP-së konsiderohen si kategori e veçantë e të dhënave personale, për pasojë LMDHP-ja përcakton kërkesa të veçanta për përpunimin e drejtë. Kontrolluesit e të dhënave mund të përpunojnë të dhëna biometrike vetëm nëse ai lloj përpunimi i të dhënave është i përcaktuar në mënyrë specifike në një ligj të veçantë. Në raste të tjera, në përgjithësi, përpunimi i të dhënave personale biometrike është i ndaluar, por si përjashtim ato mund të përpunohen mbi bazën e pëlqimit të shprehur të subjektit të të dhënave personale, të dhënë për përpunimin e këtyre të dhënave, përveç kur parashikohet me ligji që ndalimi i përpunimit të këtyre të dhënave nuk mund të tërhiqet me anë pëlqimit me shkrim të subjektit të të dhënave personale. Por edhe nëse kontrolluesi i të dhënave dëshiron të përpunojë të dhëna biometrike në bazë të pëlqimit të subjektit të të dhënave, kontrolluesi duhet të marrë miratimin nga KMDP-ja<sup>2</sup> përpara përpunimit të të dhënave biometrike. (Shiko nenin 31 të LMDHP-së).

### *Parimi i qëllimit dhe proporcionalitetit*



Respektimi i këtij parimi nënkupton, së pari, një përcaktim të qartë të qëllimit për të cilin janë mbledhur dhe përpunuar të dhënat biometrike. Për më tepër, është i nevojshëm vlerësimi i respektimit të proporcionalitetit dhe respektimit të legjitimitetit, duke marrë parasysh rreziqet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve dhe sidomos nëse qëllimi i synuar mundet ose jo të arrihet në një mënyrë më pak ndërhyrëse. **Prandaj kontrolluesit dhe përpunuesit duhet, së pari, të përcaktojnë bazën ligjore për përpunimin e të dhënave biometrike.** Nëse nuk ka një baza ligjore për këtë përpunim të të dhënave biometrike, atëherë ky përpunim është i ndaluar. Pavarësisht se pëlqimi i subjektit të të dhënave për përpunimin e të dhënave biometrike është një bazë ligjore që duhet të merren në konsideratë, siç u tha më lart, kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave gjithsesi kanë nevojë për miratimin paraprak të KMDP-së për përpunimin e të dhënave personale dhe krijimin e Koleksionit të të Dhënave Personale Biometrike.

Për shembull, për qëllime të kontrollit të aksesit (vërtetimit/verifikimit), sistemet biometrike që lidhen me karakteristika fizike të cilat nuk lënë gjurmë (p.sh. forma e dorës, por jo shenjat e

<sup>2</sup> Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

gishtave) apo sistemet biometrike që lidhen me karakteristika fizike të cilat lënë gjurmë, por që nuk mbështeten në memorizimin e të dhënave që i ka në posedim dikush tjetër përveç individit në fjalë (thënë ndryshe, të dhënat nuk memorizohen në pajisjen për kontrollin e aksesit ose në një bazë qendrore të dhënash) krijojnë më pak rreziqe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Këto lloj sistemesh në disa raste, në varësi të qëllimit, mund të konsiderohen si të përshtatshme për përpunimin e të dhënave biometrike.

### *E drejta e subjektit të të dhënave për t'u informuar mbi përpunimin e të dhënave personale vetjake*



Në rast se përpunohen të dhëna biometrike, subjekti i të dhënave duhet të informohet për qëllimet e përpunimit, identitetin e kontrolluesit, kategoritë e të dhënave në fjalë dhe marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave të ruajtura. Informacione të tjera duhet t'i ofrohen subjektit të të dhënave në rast se është e nevojshme për të garantuar përpunim të drejtë të të dhënave personale.

Subjekti i të dhënave personale, në çdo kohë, mund t'i kërkojë kontrolluesit ta informojë në lidhje me shtrirjen e të dhënave personale ose kategoritë e të dhënave personale të përpunuara në lidhje me të, mbi qëllimin(et) e përpunimit të të dhënave personale, mjetet e përpunimit (shiko nenet 12, 18 të LMDHP-së).

Informacioni që i jepet subjektit të të dhënave duhet të jetë në një formë të kuptueshme, duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, në veçanti për çdo përpunim që përfshin posaçërisht të miturit. Kur emetohet një kartë, mbajtësi i kartës duhet të informohet siç duhet për mënyrën e përdorimit të kartës dhe se çfarë të bëjë në rast mashtrimi ose përhapje të paautorizuar.

Kurdoherë që të dhënat personale përpunohen nga një sistem biometrik, subjekti i të dhënave duhet të lajmërohet (p.sh. me një sinjal zanor), përveç kur ai e ka tashmë këtë informacion.

### **III. Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale**

Në kuptimin më të gjerë, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për zbatimin e duhur të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo do të thotë se autoriteti kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve dhe mbron të drejtat e tyre.

Ky rol kryhet nga Komisioneri nëpërmjet:

- zgjidhjes së ankesave të qytetarëve për shkeljen e të drejtës së tyre për mbrojtjen e të drejtave të të dhënave me anë të inspektimit;

- kryerjes së inspektimit *ex officio* për të kontrolluar nëse parimet e mbrojtjes së të dhënave janë zbatuar siç duhet.

Megjithatë, duhet të theksohet se Autoriteti nuk ka vetëm rol kontrollues, nuk zgjidh vetëm probleme kur ato ndodhin. Përkundrazi, roli i Autoritetit është që të afrojë qytetarët më afër me të drejtat e tyre.

### ***Si të paraqesim një kërkesë për të marrë miratimin për përpunimin e të dhënave personale biometrike?***

Siç u përmend më sipër, nëse kontrolluesi i të dhënave planifikon të përpunojë të dhëna biometrike mbi bazën e pëlqimit të subjektit të të dhënave, ai duhet të marrë miratimin e KMDP-së përpara se të fillojë përpunimin. Nuk ka Formular të veçantë me anë të të cilit të paraqitet Kërkesa, por në tabelën më poshtë përcaktohen të dhënat/informacionin që duhet të përmbajë kërkesa. Për të marrë miratimin e KMDP-së për përpunimin e të dhënave personale, kontrolluesi është i detyruar të deklarojë të dhënat e mëposhtme:



**Informacioni i të dhënave që duhet të vendoset në kërkesën për miratimin e përpunimit të të dhënave personale**

**Shpjegime**

**1. Titulli i koleksionit të të dhënave personale**

**Kontrolluesi thjesht deklaron emrin/titullin e koleksionit**

P.sh. mbledhja e të dhënave personale biometrike për.....

**2. Emri, d.m.th, emri personal i kontrolluesit dhe selia e tij qendrore, adresa si dhe emri dhe adresa e përfaqësuesit të tij, nëse ka**

**3. Qëllimi ose qëllimet e përpunimit**

**Qëllimi për përpunim është shumë i rëndësishëm, kështu që kontrolluesi duhet të përcaktojë qëllimin dhe të shpjegojë arsyetimin e qëllimit.**

P.sh. Hyrja ose marrja e aksesit në një kasafortë bankare, hyrja në ambiente që mbajnë pajisje tepër sensitive dhe të shtrenjta, ose ambiente që janë sensitive në lidhje me sigurinë e përgjithshme, etj.

**4. Baza ligjore për krijimin e koleksionit të të dhënave personale**

**Kontrolluesi deklaron se baza ligjore për përpunimin e të dhënave biometrike është pëlqimi i subjektit të të dhënave**

**KUJDES: Në qoftë se baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është e përcaktuar me ligj, nuk është e nevojshme kërkesa për miratim të përpunimit të të dhënave personale**

**5. Kategoria ose kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe të të dhënave personale, dmth., kategoritë e të dhënave personale që lidhen me ta**

**Duhet të deklarohen kategoritë e të dhënave biometrike që janë objekt përpunimi.**

P.sh. shenjat e gishtave, dora, tiparet e fytyrës, irisi, retina, veshi, modeli i venave në krah, aroma, ADN-ja, etj.

**6. Përdoruesit ose kategoritë e përdoruesve të cilëve mund t'ju jepen në përdorim të dhënave personale**

**Nëse kontrolluesi i të dhënave planifikon të transferojë të dhënat biometrike tek dikush tjetër ose tek një përpunues të dhënash, ai duhet të deklarojë emrin, dmth., emrin dhe adresën e përdoruesit.**

**KUJDES : Në mënyrë që të dhënat biometrike t'ju jepen përdoruesve, duhet të ketë një bazë ligjore të përcaktuar me ligj. Në këtë rast kontrolluesi i të dhënave përcakton bazën ligjore.**

7. Afati kohor për ruajtjen e të dhënave personale

Të dhënat biometrike mund të mbahen vetëm për periudhën kohore që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve për të cilat të dhënat janë mbledhur për përpunim të mëtejshëm.

8. Transferimi i të dhënave personale tek shtete të tjera

Kontrolluesi duhet të përcaktojë nëse të dhënat biometrike transferohen në shtete të tjera, por duhet të marrë në konsideratë dispozitat e LMDP-së në lidhje me transferimin e të dhënave personale.

9. Përshkrim i përgjithshëm që do të mundësojë vlerësimin kryesor të përshtatshmërisë së masave teknike dhe organizative të marra për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të përpunimit të tyre

Duke qenë se të dhënat biometrike konsiderohen si kategori sensitive e të dhënave personale, kontrolluesi duhet të japë shpjegime të plota të detajuara të masave të sigurisë teknike dhe organizative të marra.

KUJDES: Masat teknike dhe organizative duhet të jenë të harmonizuara me masat e sigurisë të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 21, datë 24.09.2012 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga Kontrolluesit e Mëdhenj" dhe Udhëzimin Nr. 22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël" të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale.

## FAQ – Pyetjet që hasen më shpesh



### **A konsiderohen mostrat e përdorura në sistemet biometrike bashkëkohore gjithashtu si të dhëna personale?**

E dhënë personale, (sipas pikës 1 të nenit 3 të LMDHP-së) është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Nga natyra e tyre, të dhënat biometrike janë të dhëna që i referohen një personi të identifikuar ose të paktën të identifikueshëm, për shembull, shenjat e gishtave i përkasin vetëm një individ të emërtueshëm. Pyetja është: a i referohet kjo gjithashtu edhe të dhënave biometrike që ruhen në një formë të reduktuar dixhitale, mostër? Raport i Këshillit të Evropës ka vënë në dukje se dilema, nëse të dhënat biometrike janë përgjithmonë të dhëna personale, apo vetëm kur plotësohen disa kushte, është e parëndësishme. Përkatësisht, në qoftë se të dhënat biometrike janë mbledhur për qëllimin e përpunimit të mëtejshëm automatik, atëherë gjithmonë ekziston mundësia që këto të dhëna t'i atribuohen një personi të identifikuar ose të identifikueshëm, dhe që për pasojë korrespondon me përcaktimin e të dhënave personale.

Çfarëdo që do të zbatohet për karakteristikat biometrike si të tilla, do të zbatohet edhe për regjistrimin dixhital të po të njëjtave karakteristika, pavarësisht nga fakti që ato janë derivat apo se sa herë është ndryshuar së fundmi një regjistrim i tillë. Megjithëse sasia e detajeve mund të reduktojë procesin e transformimit, potencialisht ajo mbetet një lidhje unike me një person: forma, formati, mënyrën e regjistrimit ose ndryshime të tjetra nuk janë faktor thelbësor.

Bazuar në sa më sipër, mund të thuhet se të dhënat biometrike, edhe pse ruhen në një formë të reduktuar dixhitale, do të vazhdojnë të konsiderohen si të dhëna personale për shkak se ato kanë të bëjnë vetëm me një individ të caktuar, ose të identifikueshëm.

### **Përse rregullohet fusha e biometrikes në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP)?**

Të dhënat biometrike (si shenjat e gishtave, irisi, retina, tiparet e fytyrës, etj.) ofrojnë burime të karakteristikave që janë unike dhe i atribuohen vetëm një individ, dhe duke qenë karakteristika me anë të së cilave identifikohet ose të paktën është i identifikueshëm një individ, ato padyshim përbëjnë të dhëna personale. Prandaj, çdo mbledhje, ruajtje, ndarje, dërgim ose shkatërrim i këtyre të dhënave do të konsiderohet si përpunim i të dhënave personale, dhe për pasojë do të rregullohet posaçërisht nga dispozitat e LMDHP-së.

## **Përse biometria është objekt miratimi?**

Duhet të jemi të vetëdijshëm se biometrika nuk është thjesht një metodë e verifikimit apo vërtetimit të identitetit, por një teknologji që përdor si instrument të saj trupin e njeriut, ose në të vërtetë karakteristikat tona fizike ose të sjelljes të lindura. Ka një tendencë të fortë nga prodhuesit dhe shpërndarësit e sistemeve biometrike drejt banalizimit të mbledhjes së të dhënave mbi karakteristikat fizike dhe të sjelljes njerëzore. Përdorimi jo-kritik ose i pakontrolluar i karakteristikave biometrike mund të ketë pasoja serioze dhe reale për individin. Privatësia jonë mund të rrezikohet seriozisht si pasojë e mbledhjes së panevojshme dhe të paautorizuar, përdorimit, ruajtjes në mënyrë të papërshtatshme, integritit, ose transmetimit të të dhënave tona personale.

Për pasojë Autoriteti i Komisionerit është i detyruar të kryejë një ekzaminim të plotë të masave biometrike të projektuara dhe të vlerësojë nëse paraqitja e tyre është në përputhje me parimet dhe rregullat që drejtojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vlerësimit të një teknologjie individuale, përveç qëllimit që ndiqet nga kontrolluesi, autoriteti gjithashtu merr në konsideratë karakteristikat teknologjike të masave biometrike të synuara, veçanërisht dhe në mënyrë të padiskutuar nivelin e rrezikut të një teknologjie biometrike të caktuar, si p.sh. mundësia e lidhjes, dhe gjasat për të marrë kontrollin e të dhënave personale të dikujt.

## SHTOJCË – Të dhënat biometrike në vendin e punës

Kjo Shtojcë shoqëron dokumentin e Udhëzuesit në lidhje me paraqitjen e masave biometrike dhe përqendrohet në përpunimin e të dhënave biometrike në vendin e punës. Kjo guidë ka për qëllim të inkurajojë punëdhënësit që të marrin në shqyrtim nëse sistemi biometrik është në pajtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP).

Kontrolluesi duhet të ketë një arsye reale dhe të justifikueshme në kërkesën për ekzaminimin biometrik apo verifikimin e identitetit, ndërkohë që gjithashtu duhet të provohet se qëllimi për të cilin kontrolluesi ushtron kontroll nuk mund të arrihet në mënyrë të kënaqshme duke përdorur një mjet tjetër (jo-biometrik) për identifikimin ose verifikimin që nuk çënon privatësinë apo dinjitetin e individit. Punëdhënësi duhet të përcaktojë përse paraqitja e masave biometrike është e nevojshme, përkatësisht cili është qëllimi dhe synimi i këtij zbatimi. Qëllimet dhe synimet e deklaruara duhet të jenë serioze, të mirë-argumentuara dhe të mbështeten në prova (evidenca); për më tepër, duhet të kryhet një vlerësim për të parë nëse zbatimi i masave biometrike është një kusht i nevojshëm për arsye përpunimi, për sigurinë e njerëzve apo pronës, ose për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale apo biznesit. Përpara se të zbatohet çdo masë biometrike, punëdhënësi është i detyruar të shqyrtojë mundësinë nëse ka ndonjë metodë tjetër të përshtatshme, jo-biometrike, për konstatimin ose verifikimin e identitetit që mund të përmbushë në nivele të kënaqshme nevojat ose detyrimet e punëdhënësit.

Përpara paraqitjes së kërkesës pranë KMDP-së për miratimin e zbatimit të masave biometrike, është e nevojshme të vendoset se çfarë lloj sistemi është i nevojshëm, dhe si do të zbatohet ai. Sa më shumë që sistemi ndërhyt në jetën private të një individi (duke përfshirë edhe çështjet që përfshijnë mundësinë e abuzimit), aq më serioze dhe e mirë argumentuar duhet të jetë arsyeja për zbatimin e masave të tilla biometrike. Argumentimi duhet të përfshijë edhe aspektet teknike.

Nëse një shoqëri dëshiron të vërë në zbatim masa biometrike dhe provon me sukses se masat biometrike nuk janë thjesht të nevojshme, por janë të domosdoshme, dhe se objektivi thelbësor nuk mund të arrihet me mënyra të tjera më pak ndërhyrëse ose të dëmshme nga ana e privatësisë dhe dinjitetit njerëzor, atëherë përdorimi i masave biometrike të përcaktuara dhe të parashikuara mund të lejohen në vendin e punës. Megjithatë, praktika na tregon se kontrolluesit kanë tendencë të zbatojnë masa biometrike në vendin e punës thjesht sepse ato janë më praktike sesa një sistem me kartë (swipe-card sistem), dhe ata duan vetëm të parandalojnë abuzimin që ndodh si rezultat i marrjes/dhënies së kartave ndërmjet punonjësve. *Punëdhënësi duhet të provojë nevojën absolute të masave biometrike në vendin e punës për arsye thelbësore operationale, për sigurinë e njerëzve apo pronës, ose për të mbrojtur të dhëna konfidenciale dhe sekrete të biznesit. Thjesht listimi i arsyeve për zbatimin e biometrikës pa vërtetim të përshtatshëm, të mbështetur në prova, nuk i plotëson kushtet ligjore.*



## 1. Sistemet biometrike

Sistemet biometrike operojnë me përpunim automatik të të dhënave personale për identifikim ose vërtetimin/verifikimin e individëve (subjekteve të të dhënave).

Të dhënat biometrike mund të krijohen nga karakteristikat fizike, fiziologjike ose të sjelljes së një personi (si për shembull një gjurmë gishtash, irisi, retina, skica e dorës, fytyra, modeli i zërit, ADN-ja, aroma e trupit, shkrimi i dorës, analiza e dinamikës së shtypjes së tastave në tastierë, etj ). Një mostër dixhitale prodhohet nga programe të veçantë. Më pas mostra krahasohet me atë që punonjësi paraqet realisht tek lexuesi.

Në shumë sisteme biometrike që aplikohen në një vend pune përdoren të dhëna pjesërisht të koduara (që përbëhen nga imazhi origjinal, por që nuk mund të përdoret për të rindërtuar imazhin e plotë origjinal të të dhënave).

Ka dy lloje kryesore të sistemeve biometrike

- sistem identifikimi: sistemi konfirmon identitetin e një individi (për këtë sistem është e nevojshme të krijohet një bazë qendrore të dhënash me të dhënat personale. Baza qendrore ruan mostrat në një sistem qendror i cili më pas kërkon çdo herë që një punonjës paraqitet tek lexuesi. Ky sistem quhet 1 me shumë).
- sistem vërtetimi/verifikimi: sistemi konfirmon se një e dhënë biometrike që vjen nga një person në kohë reale është identik me mostrën e ruajtur më parë në një kartë (sistemi i krahasoni dy të dhënat biometrike. Ky sistem quhet 1 me një).

## 2. Parimet e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me biometrikën në vendin e punës

### Proporcionaliteti

Neni 5 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP) parashikon se *“Të dhënat personale duhet të jenë: të mjaftueshme, në lidhje me qëllimin e përpunimit dhe të mos i tejkalojnë këtë qëllim”*.

Fjala e rëndësishme dhe pothuajse kyç në këtë fjali është **“tejkalimi”**. Gjatë shqyrtimit të zbatimit të sistemit biometrik, pyetja e parë që duhet konsideruar është: cila është nevoja për ta patur? A ekziston

sistem alternativ më pak ndërhyrës që jep të njëjtin efekt dhe rezultat? A është punëdhënësi në dijeni se punonjësit kanë të drejta themelore që mbrohen nga Kushtetuta, Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale? Punëdhënësi duhet të bëjë një vlerësim të nevojës për sistemin biometrik dhe të shqyrtojë llojet e ndryshme të modeleve alternative të sistemit të veçantë biometrik.

Një kriter tjetër i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë, janë rrethanat (ambienti) qëllimi, efikasiteti dhe besueshmëria.

**Rrethanat** - punëdhënësi do të vlerësojë natyrën e vendit të punës (me të vërtetë vendi i punës kërkon një nivel të lartë sigurie?). Është e nevojshme të përpunohen të dhëna sensitive (biometrike)?



Qëllimi – punëdhënësi duhet t’i japë përgjigje pyetjes “a mund të arrihet qëllimi i synuar me anë të një mënyre më pak ndërhyrëse?”

**Efikasiteti** – punëdhënësi duhet t’i japë përgjigje pyetjes “A jam gati t’i ofroj administratës masa të cilat janë të nevojshme për funksionimin e sistemit?”

### **Marrja dhe përpunimi i drejtë i informacionit**

Neni 5 i LMDHP-së parashikon se “*Të dhënat personale do të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme*”.

Për të përmbushur pajtueshmërinë me këtë dispozitë të Nenit 5 duhet të përmbushet, të paktën një nga dispozitat e Nenit 6 të LMDHP-së:

- Pëlqimi i punëmarrësit;
- kur përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën punëmarrësi është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave;
- për përmbushjen e një detyrimi ligjor, objekt i të cilit është punëdhënësi;
- kur përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetik të të punësuarve;
- kur përpunimi është i nevojshëm për qëllime të interesit publik ose ose ushtrimin e një kompetence të punëdhënësit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- kur përpunimi është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave legjitim të punëdhënësit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar, përveç kur përpunimi çënon të drejtat dhe liritë themelore ose të drejtat legjitime të punëmarrësve.

Duhet shtuar se pëlqimi i punëmarrësit nuk është në përgjithësi një bazë e pranueshme ligjrisht në kuadër të punësimit nëse nuk është dhënë lirisht. Vetëm kur punëdhënësi ofron një përpunim të të dhënave biometrike si opsion, atëherë pëlqimi mund të shihet si i dhënë lirisht (dmth. punëdhënësi ka patur një zgjedhje).

### Marrja e drejtë e të dhënave sensitive

Duhet të theksohet se sipas dispozitave të nenit 3 të LMDHP-së të dhënat biometrike do të konsiderohet si “të dhëna personale të veçanta” (dmth. si një e dhënë sensitive).

Neni 3 (4) parashikon “Të dhëna sensitive” është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Për përpunimin e të dhënave biometrike (si të dhëna sensitive) duhet të plotësohet, të paktën, një nga dispozitat e Nenit 7 të LMDHP-së:

- Pëlqimi i shprehur i punëmarrësit;
- Përpunimi është i nevojshëm për ushtrimin apo zbatimin e një të drejte specifike dhe detyrimi që imponohet ose buron nga Ligji i Punës (në lidhje me punësimin);
- Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave themelore të punëmarrësit ose të personave të tjerë;
- Përpunimi është i nevojshëm për përcaktimin ose përmbushjen e një interesi individual ligjor;
- Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të përfitimit, ushtrimit, ose mbrojtjes së të drejtave ligjore të punëmarrësve.

Është e nevojshme të theksohet se fjala kyç në dispozitat e sipërpërmendura është “i nevojshëm”.

### Transparenca

Neni 18 i LMDHP-së kërkon që subjekti i të dhënave duhet të jetë “informuar” mbi disa aspekte të përpunimit të të dhënave.

Në përputhje me Nenin 18, një punëdhënësi duhet të ofrojë të paktën informacionin e mëposhtëm për punëmarrësit kur përpunon të dhënat e tyre personale:

- Identiteti i punëdhënësit (ose përfaqësuesi i tij i autorizuar)
- Qëllimi i përpunimit të të dhënave
- Çdo palë e tretë së cilës i përhapen të dhënat biometrike. (Përhapje të të dhënave kemi kur një shoqëri tjetër administron, mirëmban ose menaxhon sistemin. Përhapja mbulon gjithashtu dërgimin e të dhënave biometrike tek një shoqëri mëmë).

Kërkesa thelbësore është që punëmarrësit të jenë në dijeni të qëllimit për të cilin janë mbledhur dhe do të përpunohen të dhënat biometrike. *Kjo do të thotë që një punëdhënësi duhet të mendojë me kujdes çdo qëllim. Transparenca është shumë e rëndësishme në një rast ku sistemi biometrik nuk kërkon dijeninë*




ose pjesëmarrjen aktive të punëmarrësve (si për shembull; sistemi i njohjes së fytyrës mund të kapë dhe të përpunojë imazhe të punëmarrësit pa dijeninë e tij).

## Saktësia

Neni 5 i LMDHP-së parashikon se *“Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme duhet të përditësohen, ku të ndërmerret çdo hap i arsyeshëm për të fshirë dhe korrigjuar të dhënat e pasakta ose të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin ato mbliidhen ose përpunohen më tej”*.

Çdo sistem biometrik duhet të identifikojë saktësisht personat, të dhënat e të cilëve përpunohen nga sistemi. Nëse një karakteristikë fizike apo fiziologjike e punëmarrësit ndryshon, atëherë kjo duhet të reflektohet në mostër. Mostra nuk do të jetë e vjetërsuar. Procedura e ndryshimit të mostrës duhet të sigurojë që të dhënat të jenë të përditësuara.



## Siguria

Neni 27 i LMDHP-së kërkon që *“Kontrolluesi ose Përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.”*

Punëdhënësi do të vlerësojë dhe të vendosë se çfarë përbën një masë të përshtatshme të sigurisë. Për ta bërë këtë gjë, së paku, duhet të marrë parasysh katër faktorë:

- gjendjen e zhvillimit teknologjik;
- koston e zbatimit të një teknologjie;
- natyrën e të dhënave të mbrohen;
- dëmin dhe rreziqet që mund të rezultojnë nga përpunimi i jashtëligjshëm i të dhënave.

Për sistemin e përpunimit të të dhënave biometrike ka disa standarde minimale të sigurisë:

- aksesin në sistemin biometrik do të jetë i kufizuar vetëm për personelin e autorizuar (mbi bazën e parimit “të nevojës për të ditur” në përputhje me politikën e brendshme të përcaktuar);
- sistem kompjuterik i mbrojtur me fjalëkalim;

- dokumentet teknike, informacioni i ekraneve, dosjet teknike manuale do të fshihen nga persona të cilët nuk janë të autorizuar për t'i parë;
- procedurë e rregullt për krijimin e kopjeve të sigurisë (back-up) të të dhënave kompjuterike; ruajtja e kopjeve të sigurisë; do të ruhen jashtë ambientit;
- punëmarrësit të jenë në dijeni të regjimit dhe masave të sigurisë në vendin e punës dhe të jenë në pajtim me to;
- të gjitha dokumentet, printimet nga kompjuteri, etj, të përdoren sipas një regjimi të kujdesshëm shkatërrimi;
- të emërohen persona përgjegjës për sigurinë e sistemit;
- të krijohet një regjim rishikimi periodik i sigurisë, masave dhe praktikës;
- mjediset e punës të mbrohen në mënyrë të përshtatshme, gjatë kohës që nuk ka njeri;
- nëse përpunimi i të dhënave personale kryhet nga një përpunues në emër të punëdhënësit, duhet të ekzistojë një kontratë me shkrim.

### Koha e ruajtjes së të dhënave

Neni 5 i LMDHP-së parashikon se të dhënat personale të përpunuara mund “*të mbahen në një formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.*”

Në kuadër të sistemit biometrik në vendin e punës, është e nevojshme të hartohet dhe të shkruhet një politikë për ruajtjen e të dhënave, në veçanti në lidhur me të dhëna biometrike. Kjo politikë do të miratohet përpara fillimit të funksionimit të sistemit. *Duhet gjithashtu të sigurohet që sapo një punëmarrës largohet përfundimisht nga vendi i punës, të dhënat e tij biometrike do të fshihen menjëherë.*

